



Burimi: <http://www.panorama.com.al/2012/11/24/burrel-vendoset-ne-qender-busti-i-patriotit-shahin-toçi/#ixzz2FPLa1gqu>

Burrel, vendoset në qendër busti i patriotit Shahin Toçi

BURREL – Në prag të 100-vjetorit të pavarësisë, në qendër të Burrelit vendoset shtatorja e Shahin Toçit, dëshmorit që dha jetën për flamurin kuqez, pasi nuk pranoi të betohej para flamurit italian. Qindra qytetarë morën pjesë në ceremoninë e organizuar, duke parë nga afër veprën e punuar nga Muntaz Dhrami. Kryebashkiakja Adelina Farrici, e cila tha se “akti i Shahin Toçit i kapërceu malet e kësaj treve dhe u shtri e bëri jehonë në të gjithë Shqipërinë e më gjerë, kur nuk pranoi të betohej para flamurit italian në Romë. Duke nderuar këto figura, ne vlerësojmë dhe respektojmë aktet e tyre heroike për atdheun, njëherazi transmetojmë e mbajmë gjallë ndër breza traditat e larta të popullit tonë, kultivojmë në shpirtin e tyre frymën e shqiptarizëm e të atdhedashurisë, përkushtimin e devotshmërinë për t’i dalë zot atdheut e kombit”. Të pranishmit e shumtë i përshëndeti ministri i Mbrojtjes, Arben Imami, duke u uruar atyre fillimisht 100-vjetorin e pavarësisë. Ai vlerësoi Mbretin Zog, duke u shprehur se nuk është rastësi që ai është bir i Matit. “Nuk ka ditë më të përshtatshme sesa kjo për të kujtuar dëshmorët, njërin prej të cilëve e nderojmë sot me këtë shtatore. Vepra e tij do të mbetet e paharruar ndër vite”, pohoi Imami në Burrel. h.p

